

Dehari thotë se pa marrëveshje s’thirret seanca, opozita paralajmëron veprime



Faqe 2

Vuçiçi thotë se ndërhyri që të mos lejohet hapja e Urës së Ibrit




Faqe 3

Mbi 250 të vdekur nga tërmeti në Kolumbi, vazhdon kërkim-shpëtimi



Faqe 6

PSG-ja kërkon tjetër trofe evropian



Faqe 15

e mërkurë • 12 gusht 2026

Numri 10452

KOHA

DITORE

www.koha.net



PROVOKIMET SISTEMATIKE TË SERBISË NDAJ KOSOVËS NUK JANË SHUMË SHQETËSUESE PËR INSTITUCIONET NDËRKOMBËTARE

KE-ja dhe SHBA-ja me reagime të “matura” ndaj deklaratave kërcënuese të Vuçiçit

Zëdhënësja e BE-së për çështje të jashtme, Annita Hipper, nuk ka komentuar nëse deklaratat e Vuçiçit për ndryshimin e rrjedhës së lumit Ibër do të kenë pasoja për rrugëtimin e Serbisë drejt integritimeve evropiane. Ajo vetëm ka thënë se këto veprime nuk mbështesin qëllimin për normalizimin e raporteve mes Kosovës dhe Serbisë. E në reagimin e Departamentit amerikan të Shtetit, thuhet se paqja dhe stabiliteti në Ballkanin Perëndimor mbeten prioritetet e SHBA-së

Komisioni Evropian nuk ka komentuar në mënyrë direkte deklaratat e presidentit të Serbisë për planet për ndryshimin e rrjedhës së lumit Ibër dhe nëse një gjë e tillë do të ketë pasoja për rrugëtimin e Serbisë drejt integritimeve evropiane. Në vend të kësaj, zëdhënësja e BE-së për çështje të jashtme, Annita Hipper, vetëm ka rikujtuar se deklaratat e tilla nuk e ndihmojnë normalizimin e raporteve mes Kosovës dhe Serbisë, ndërsa ky normalizim është parakusht për progresin drejt BE-së për të dyja palët.

Gazetari në konferencë për shtyp në Bruksel bëri pyetje nëse Komisioni Evropian mund të thotë se deklaratat në Serbi për mundësinë e ndryshimit të rrjedhës së lumit Ibër mund të kenë pasoja për procesion e integritetit të Serbisë në BE.

“Do të nisi me çështjen kryesore, ajo është deklarata e bërë, përfshirë ajo për ndryshimin e rrjedhës së lumit. Këto veprime nuk mbështetin qëllimin për normalizimin e raporteve mes Kosovës dhe Serbisë. Kjo mund të bëhet vetëm përmes dialogut. Po ashtu rikujtojmë se progresi në dialog mes Beogradit dhe Prishtinës është parakusht për avancim në rrugëtimin Evropian”, është përgjigjur Anita Hipper.

Gazetari pastaj bëri krahasimet me reagimin që Komisioni Evropian kish-te në rastin kur në Shqipëri shpërthyen protestat kundër një planndërtimi në

Zvërnec kur thanë se projekti në Zvërnec, nëse vazhdon, do të ketë pasoja për integritimin evropian.

Zëdhënësja e Komisionit Evropian, Ariana Podesta, ka thënë se nuk duan të spekulojnë rreth ndikimeve në procesin e zgjerimit.

“Nëse themi një gjë për një rast nuk mund të them të njëjtën për rastin tjetër, sepse situatat janë të ndryshme”, ka thënë ajo.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, ka kërcënuar se do të shikojnë mundësinë e ndryshimit të rrjedhës së lumit Ibër duke kërcënuar me fjalët “të shohim se çfarë do të bëjnë shqiptarët pastaj”. Ndaj kësaj një ditë më herët kanë reaguar edhe në Kosovë edhe në Shqipëri. E të martën edhe Departamenti amerikan i Shtetit, duke thënë se paqja dhe stabiliteti në Ballkanin Perëndimor mbeten prioritetet e Shteteve të Bashkuara.

“Normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës është pjesë e domosdoshme e këtij procesi”, ka deklaruar zëdhënësi i DASH-it për Radio Evropën e Lirë.

Në debatin për lumin Ibër është përfshirë edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama.

“Serbia është plotësisht e lirë të menaxhojë burimet brenda juridiksionit të saj. Ajo që nuk mund të argumentojë në mënyrë të arsyeshme është se pasojat e mundshme për një vend tjetër ndalen në mënyrë magjike në kufirin serb”, shkroi Rama.



Kurti kërkon prezencë të përhershme ushtarake amerikane në Kosovë

Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka përsëritur kërkesën që Kampi Bondsteel të shndërrohet në një prezencë të përhershme ushtarake amerikane në Kosovë. Në takimin me senatoren amerikane Joni Ernst, Kurti theksoi se një prezencë e tillë do të shërbente si garantuese e paqes dhe sigurisë në Kosovë dhe rajon, si dhe do të përbënte një bazë strategjike për operacionet e NATO-s në Evropën Juglindore. Senatorja Ernst gjatë qëndrimit në Kosovë u dekorua me Medaljen Presidenciale të Meritave nga ushtruesja e detyrës së presidentes, Albulena Haxhiu. Bondsteeli është bazë ushtarake amerikane në Kosovë, e ndërtuar në afërsi të Ferizajt, në vitin 1999

ZBARDHET DOKUMENTI I PROKURORISË PËR TË AKUZUARIT NË MUNGESË, PËR KRIME LUFTE NË GJAKOVË

Krahas 107 vrasjeve, 20 serbë akuzohen edhe për plaçkitje e dëbim

Donisa Fazliu

PRISHTINË, 11 GUSHT – Në maj të vitit 1999, për tri ditë radhazi, në Gjakovë u zhvillua një operacion i forcave serbe, gjatë të cilit u vranë 107 civilë shqiptarë.

Për këtë rast, javën e kaluar Prokuroria Speciale ngriti aktakuzë në mungesë ndaj 20 personave, në mesin e të cilëve është edhe i akuzuari kryesor për sulmin terrorist në Banjskë, Milan Radoičiq.

Në aktakuzën e Prokurorisë, të cilën e ka siguruar KOHA thuhet se të pandehurit në lokacionin e njohur si “Ura e Taliqit”, të uniformuar dhe të armatosur me armë të llojeve të ndryshme, i kanë rrahur, maltretuar e më pas vrarë civilët shqiptarë.

“Nën kërcënimin e armëve, u detyruan të largoheshin në drejtim të lokacionit të njohur si ‘Ura e Taliqit’.

Gjatë kësaj lëvizjeje të detyruar nëpër rrugët e qytetit, nëpër shtëpi dhe oborre të ndryshme, si dhe në lokacionin tek ‘Ura e Taliqit’, këta pjesëtarë të forcave serbe kanë vrarë një numër të madh civilësh, kryesisht shqiptarë, me ç’rast një pjesë e viktimave janë varrosur në varrezat e qytetit të Gjakovës, ndërsa pjesa tjetër janë marrë dhe për fatin e tyre nuk është ditur deri pas përfundimit të luftës, kur janë gjetur në varreza masive në Batajnicë të Serbisë, çka dëshmon për përpjekjet e organizuara dhe sistematike për fshehjen e krimeve të kryera ndaj popullatës civile”, thuhet në aktakuzë.

Sipas aktakuzës, të pandehurit i ndanë gratë dhe fëmijët nga meshkujt, dhe mbi 300 civilë shqiptarë u dërguan në burgje e objekte të improvizuara.

“U mbajtën në kushte çnjerëzore dhe degraduese, pa kushte elementare për jetesë, siç janë ushqimi i rregullt, higjiena bazike dhe kujdesi shëndetësor”, thuhet në dokumentin e Prokurorisë Speciale. “U dërguan në burgjet në Kosovë, e më pas u transferuan në burgje në territorin e Serbisë, ku u mbajtën deri pas përfundimit të luftës, kur edhe u liruan me ndërmjetësimin dhe ndihmën e organizatave ndërkombëtare”.

Në dokument thuhet se i plaçkitën gratë, duke ua marrë stollitë e arit, paratë dhe sendet e tjera me vlerë, e më pas i dëbuan.

“I nxorën me forcë në oborret e shtëpive, ashtu që fillimisht i ndanë gratë dhe fëmijët nga meshkujt, me ç’rast gratë i plaçkiten duke ua marrë stollitë e arit, paratë dhe sendet me vlerë, ndërsa meshkujt i

detyruan t’i nënshtroheshin verifikimit të identitetit e më pas disa prej tyre i ekzekutuan në shtëpitë dhe oborret e tyre, kurse disa të tjerë u arrestuan dhe burgosen, kurse gratë dhe fëmijët nën kërcënimin e armëve, u detyruan të largoheshin nga shtëpitë e tyre në drejtim të lokacionit të njohur si ‘Ura e Taliqit’, dhe prej aty u detyruan të bashkoheshin me kolonat e refugjatëve që largoheshin në drejtim të Republikës së Shqipërisë”, thuhet në aktakuzë.

Sipas Prokurorisë, të pandehurit serbë, për të fshehur gjurmët e krimeve e me qëllim të spastrimit etnik të territorit, në qytetin e Gjakovës gjatë muajit maj 1999 u vunë zjarrin shtëpive të disa familjeve, duka u shkakuar edhe dëme materiale në mënyrë të qëllimshme.

© KOHA Ditore

Komuna i kërkon Ministrisë së Kulturës bashkëpunim për sallën koncertale



Janë bërë gati dy vjet prej kur projekti është miratuar nga institucionet e trashëgimisë kulturore, tenderimi e nisja e punimeve për sallën koncertale në Prishtinë as që shihet në horizont. Procesi i nisur të paktën tash e tetë vjet ende ngelet pa vizion se kur do të realizohet projekti më i kërkuar nga komuniteti kulturor...

Faqe 10